



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.692/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gjakovë, Ilir Morina nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Ilir Morina nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Ilir Morina nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se bazuar në deklaratat e disa votuesve familjar që kanë votuar në vendvotimet: 0202C/1R, 0202C/2R, 0201C/3R, 0212C/1R, 212C/6R,0202C/13R, votat mungojnë, dhe që ka mospërputhje të votave në rezultatin preliminar me atë përfundimtar.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk e specifikon se sa vota dyshon që i mungojnë dhe sa pretendon se i posedon dhe për pretendimet e tij lidhur me parregullsit nuk ka ofruar asnjë dëshmi.

Parashtrimet në ankesë nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesen .

Paneli vlerësoi se pretendimet në ankesë nuk janë te bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 5.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është e pa bazuar dhe si të tillë e refuzoi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.692/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*